

Bazuar në nenin 19 të Statutit të Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës dhe nenin 393 të Statutit të Universitetit të Tetovës, Parlamenti Studentor i Universitetit të Tetovës, në mbledhjen e mbajtur më 12.12.2016 solli:

**R R E G U L L O R E**  
**për organizimin e zgjedhjeve për Kryetar të Parlamentit Studentor në Universitetin e Tetovës dhe në njësitë e Universitetit të Tetovës**

**Neni 1**

Me këtë Rregullore rregullohen çështjet e lidhura me organizimin e zgjedhjeve për Kryetar të Parlamentit Studentor në Universitetin e Tetovës (në tekstin e mëtuqjeshëm: në Universitet), zgjedhjen e kryetarëve të Parlamenteve Studentore të fakulteteve dhe anëtarëve të Parlamenteve Studentore të fakulteteve.

**Neni 2**

Realizimi i zgjedhjeve studentore është detyrim në kompetencat e Komisionit zgjedhor të Parlamentit Studentor të Universitetit.

**Neni 3**

Komisioni zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit:

- Kujdeset për organizim statutar të zgjedhjeve;
- Verifikon a janë propozuar kandidatët në pajtim me këtë Rregullore;
- Në afate të përcaktuara përgatit listat e kandidatëve, kurse më pas publikon listat zyrtare;
- Sjell vendime për rrjedhën e zgjedhjeve në pajtim me këtë Rregullore;
- Përpilon formularë për kandidaturë, procesverbale, fletëza votimesh;
- I verifikon dhe i publikon rezultatet e votimit;
- Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Statutin e Parlamentit Studentor të Universitetit dhe me këtë Rregullore.

**Neni 4**

Studentët e zgjedhur i gëzojnë të drejtat dhe obligimet e përcaktuara me Statutin dhe Rregulloren e punës së Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës, Statutin e Universitetit, Ligjin për arsim të lartë dhe aktet tjera juridike, në të cilat përcaktohen çështjet e rëndësishme për studentët.

**Neni 5**

Zgjedhjet studentore realizohen me votime të fshehta, të drejtpërdrejta dhe në kushte të barabarta.

## **Neni 6**

Për organizimin e zgjedhjeve, Parlamenti Studentor i Universitetit, në mbledhjen e Parlamentit, me shumicë votash prej 2/3 formon Komisionin zgjedhor.

Komisioni zgjedhor numëron 7 anëtarë. Anëtarët e Komisionit zgjidhen nga fushat e ndryshme shkencore.

## **Neni 7**

Votimi i Komisionit zgjedhor është i hapur.

## **Neni 8**

Anëtarët e Komisionit zgjedhor, në mbledhjen e parë, të cilën e drejton anëtari më i moshuar, zgjedhin Kryetarin e komisionit që do t'i organizojë zgjedhjet për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit, kryetar të Parlamentit Studentor të fakultetit dhe anëtarë të Parlamentit Studentor të fakultetit.

Kryetari i komisionit nuk guxon të jetë anëtar i ndonjë partie politike.

## **Neni 9**

Mandati i anëtarëve të komisionit është dy vjet.

Në vend të studentëve - anëtarëve të komisionit zgjedhor, të cilëve do t'u përfundojë statusi i studentit, zgjidhen anëtarë të rinj të Parlamentit Studentor të Universitetit, nga fushat shkencore prej të cilave vijnë, të propozuar prej minimalisht 3 anëtarëve ose prej Parlamentit Studentor të fakultetit.

## **Neni 10**

Për punën e tyre, anëtarët e komisionit zgjedhor marrin honorare të përcaktuara dhe të miratuara nga ana e Kryetarit të Parlamentit Studentor të Universitetit.

## **Neni 11**

Komisioni zgjedhor vendos me shumicë të thjeshtë.

## **Neni 12**

Kundër vendimeve të Komisionit zgjedhor të Universitetit mund të bëhet ankesë deri te Parlamenti Studentor i Universitetit në afat prej 24 orësh, nga dita e pranimit të vendimit të Komisionit zgjedhor të Universitetit.

Kundër vendimeve të Komisionit zgjedhor të fakultetit, propozuesi ka të drejtë ankimi në Komisionin zgjedhor të Parlamentit Studentor të Universitetit.

### **Neni 13**

Për organizimin më të lehtë të zgjedhjeve studentore, Komisioni zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit, formon komisione zgjedhore të veçanta për secilin fakultet.

### **Neni 14**

Komisioni zgjedhor i Parlamentit Studentor të fakultetit numëron 3-5 anëtarë, varësisht nga numri i studentëve në njësitë e Universitetit.

Anëtarët e Komisionit zgjedhor i zgjedh Komisioni zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit.

### **Neni 15**

Anëtarët e Komisionit zgjedhor të fakultetit, në mbledhjen e parë të cilën e drejton anëtari më i moshuar, zgjedh Kryetarin nga radhët e veta.

Kryetari i Komisionit zgjedhor nuk guxon të jetë anëtar i ndonjë partie politike.

### **Neni 16**

Mandati i anëtarëve të Komisionit zgjedhor të fakultetit është 2 vjet.

Në vend të studentëve, anëtarëve të Komisionit zgjedhor të cilëve do t'u përfundojë statusi student, zgjidhen anëtare të rinj nga Komisionit zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit.

### **Neni 17**

Për punën e tyre, anëtarët e Komisionit zgjedhor marrin honorare, të përcaktuar nga Kryesia e Parlamentit Studentor të Universitetit.

### **Neni 18**

Komisioni zgjedhor vendos me shumicë të thjeshtë.

### **Neni 19**

Kundër vendimeve të Komisionit zgjedhor të fakultetit, në afat prej 24 orëve nga pranimi i vendimit, mund të bëhet ankesë te Komisioni Zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit.

### **Neni 20**

Rezultatet e zgjedhjeve të çdo fakulteti i publikon Komisioni Zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit.

Komisioni zgjedhor i fakultetit, kutitë votuese, të vulosura nga zgjedhjet e mbajtura i sjell në selinë e Komisioni zgjedhor të Universitetit dhe në prani të anëtarë të Komisioni zgjedhor i hapin dhe i numërojnë fletëvotimet dhe e vërtetojnë rezultatin e votimit, e vëndojnë në procesverbalin e zgjedhjeve të mbajtura. Procesverbalin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e Komisionit zgjedhor të fakultetit.

Procesverbalin dhe materialin e kompletuar votues Komisioni zgjedhor i fakultetit ia dorëzon Komisionit zgjedhor të Parlamentit Studentor të Universitetit për realizimin e procedurës së mëtutjeshme.

### **Neni 21**

Zgjedhjet i realizon Komisioni zgjedhor i fakultetit, i vendosur në një vend të dukshëm të ndërtesës së fakultetit ose në korridorin kryesor.

### **Neni 22**

Procesi i zgjedhjeve të Kryetarit të Parlamentit studentor të Universitetit, Kryetarit të Parlamentit studentor të fakultetit dhe anëtarëve të Parlamentit studentor të fakultetit organizohen në të njëjtën ditë.

Zgjedhjet sipas paragrafit paraprak organizohen gjatë semestrit dimëror të Vitit kalendarik.

### **Neni 23**

Datën e organizimit të zgjedhjeve e cakton Komisioni zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit.

Me vendim të veçantë, Komisioni zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit cakton:

- ditën e organizimit të zgjedhjeve;
- afatin për kandidim për Kryetar të Parlamentit studentor të Universitetit, Kryetar të Parlamentit studentor të fakultetit dhe për anëtarë të Parlamentit studentor të fakultetit është 7 ditë nga dita e vendimit për mbajtjen e zgjedhjeve ;
- kohëzgjatjen e fushatës së kandidatëve;
- ditën e shpalljes së vendimeve për kandidatët e zgjedhur dhe
- afatin për dorëzimin e ankesave rreth rezultateve të zgjedhjeve.

Komisioni i paragrafit paraprak e nis me procedurë të shpejtë procesin e propozimit të kandidatëve për anëtarë të komisioneve zgjedhore të fakulteteve.

### **Neni 24**

Komisioni zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit e publikon vendimin e paragrafit paraprak në tabelën e shpalljeve të njësisë së Universitetit.

## **Neni 25**

Zgjedhjet realizohen përmes votimit, në ditë pune dhe zgjasin 8 orë, nga ora 9:00 deri në orën 17:00.

Nëse ka ndërprerje dhe nëse votimi ka nisur më vonë, termini vazhdohet për aq kohë sa ishin të ndërprera ose të vonuara zgjedhjet.

## **Neni 26**

Në pajtim me Statutin e Universitetit të Tetovës, të drejtë votimi kanë të gjithë studentët aktiv, të cilët statusin e tyre e dëshmojnë me indeksa.

## **Neni 27**

Gjatë votimit, studenti shënon në një listë të veçantë emrin dhe mbiemrin e tij, numrin e indeksit dhe në të njëjtën listë nënshkruhet.

Indeksi konsiderohet si dokument identifikimi i studentit që voton.

## **Neni 28**

Komisioni zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit përcakton me vendim:

- pamjen e fletës së votimit;
- përmbajtjen e fletës së votimit, veçmas organin që organizon zgjedhjet, emrin dhe mbiemrin e kandidatit – kandidatëve dhe vulën;
- mënyrën e votimit, me rrethim të numrit rendor përpara emrit të kandidatit i cili zgjidhet;
- cili fletëvotim konsiderohet si i pavlefshëm dhe
- çështje të tjera të lidhura me organizimin e zgjedhjeve.

Komisioni zgjedhor përgatit një fletëvotim për zgjedhjen e Kryetarit të Parlamentit Studentor të Universitetit.

## **Neni 29**

Mjetet për realizimin e zgjedhjeve sigurohen nga buxheti i Parlamentit Studentor të Universitetit.

## **Neni 30**

Me qëllim të realizimit të zgjedhjeve cilësore dhe në kohë, Komisioni zgjedhor Parlamentit Studentor të Universitetit publikon kalendarin e aktiviteteve që duhet të realizohen gjatë procesit zgjedhor:

- Kandidati për zgjedhje paraqitet në afat prej 7 ditësh nga dita e vendimit për mbajtjen e zgjedhjeve;
- Komisioni zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit , në afat prej 24 orësh shpall listën e kandidatëve për zgjedhje;

- Të interesuarit mund të bëjnë ankesa në lidhje me listën e shpallur në afat prej 24 orësh;
- Fushata e kandidatëve zgjat 5 ditë para zgjedhjeve dhe vazhdon deri në ditën e fundit të mbajtjes së zgjedhjeve. Dita e fundit shpallet si ditë e heshtjes zgjedhore.

Kandidatët e zgjedhjeve gëzojnë mundësitë e njëjta për prezantim përpara studentëve.

Prezantimi nuk mund të bëhet 24 orë para ditës së përcaktuar për organizimin e zgjedhjeve.

### **Neni 31**

Gjatë kohës së zgjedhjeve dhe pas tyre mbahet procesverbal, të cilin e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e komisionit zgjedhor.

Në procesverbal jepen të dhënat në vijim: numri i fletëve të votimit, numri i votave për secilin kandidat, numri i fletëvotimeve të pavlefshme, emrat dhe mbiemrat e të gjithë anëtarëve të komisionit zgjedhor, vërejtjet lidhur me mbarëvajtjen e votimeve.

Procesverbali i nënshkruar nga anëtarët e Komisionit zgjedhor i dorëzohet Komisionit zgjedhor të Parlamentit Studentor të Universitetit.

### **Neni 32**

Parregullsitë eventuale të lidhura me zgjedhjet mund t'i paraqesë në formë të shkruar çdo student, anëtar i njësive akademike përpara Komisionit zgjedhor të Parlamentit Studentor të Universitetit.

### **Neni 33**

Të drejtën e kandidimit për kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit e gëzon çdo student shtetas i Republikës së Maqedonisë, i cili i plotëson kushtet e përcaktuara me Statutin e Parlamentit Studentor të Universitetit dhe me këtë Rregullore.

**Kryetari i Parlamentit Studentor të Universitetit zgjidhet me mandat prej 2 vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje.**

### **Neni 34**

Kandidati për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit duhet ta ketë përkrahjen e 1000 (njëmijë) nënshkrimeve të studentëve, prej të cilave detyrimisht në 7 fakultete të ketë përkrahje prej 50-100 nënshkrime.

Kandidati për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit me dorëzimin e kandidaturës për kryetar të dorëzojë kandidaturat për 11 kandidatë për Kryetar të Parlamentit Studentor të fakulteteve dhe 20 kandidatura për anëtarë në Parlamentin Studentor të fakulteteve .

Paraqitjet kandidati i dorëzon deri te Komisioni zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit. Selia e Komisionit zgjedhor të Parlamentit Studentor të Universitetit është në Rektoratin e vjetër të Universitetit të Tetovës, tek objekti ku gjendet Fakulteti i Shkencave të Zbatuara , në rrugën e Ilindenit p.n. Tetovë – kabineti numër 9.

Paraqitja nga paragrafi i mësipërm kryhet në afat prej 7 ditësh nga dita e shpalljes së vendimit për mbajtjen e zgjedhjeve në Parlamentin Studentor të Universitetit.

### **Neni 35**

Kandidati për zgjedhje Kryetar i Parlamentit Studentor të Universitetit , nga komisioni zgjedhor merr fletën-formular në të cilën detyrimisht shënohen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri i kandidatit, numri amë,nota mesatare , nr. i telefonit celular,vërtetimi se është student i rregullt, deklarata se nuk është anëtar i organeve të partisë apo rinisë partiake.

Kandidati për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit paraqet edhe programin e punës të Parlamentit Studentor të Universitetit.

Kriteret për zgjedhjen e kryetarit të Parlamentit të Studentëve të Universitetit janë të përcaktuara në Statutin të Parlamentit Studentor të Universitetit.

Kandidati për zgjedhje për Kryetar të Parlamentit Studentor të Universitetit në fletën-formularin në paragrafin 1 të këtij neni, i plotësojnë edhe të dhëna të përgjithshme për 11 Kryetarët e Parlamentit Studentorë të fakulteteve dhe 20 anëtarë të Parlamentit Studentor të Fakulteteve .

Fletat –formularët në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, do t'i përgatisë Komisionin Zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit.

### **Neni 36**

Komisioni Zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit me pranimin e fletëve – formularëve për kandidim verifikon a janë dorëzuar në afatin e përcaktuar dhe a janë përpiluar në pajtim me Rregulloren.

Nëse Komisioni zgjedhor verifikon se kandidaturat e kandidatëve janë në pajtim me Statutin e Parlamentit Studentor të Universitetit dhe në pajtim me këtë Rregullore, i verifikon dhe i vërteton propozimet e kandidatëve.

Nëse Komisioni Zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit vërteton se kandidatura nuk është paraqitur brenda afateve të përcaktuara në këtë Rregullore ose nuk janë në pajtim me Statutin e Parlamentit Studentor të Universitetit dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje, do të sjellë vendim dhe të njëjtën do ta refuzojë, ndërkaq, nëse nuk është e plotë dhe ka parregullsi të natyrës teknike, do t'i ftojë të interesuarit t'i plotësojnë në afat prej 24 orësh.

Nëse aplikuesit nuk veprojnë në pajtim me kërkesën e Komisionit dhe brenda afatit të përcaktuar, Komisioni nuk do t'i fusë kandidatët në listën zyrtare të kandidatëve për zgjedhje.

### **Neni 37**

Në bazë të kandidaturës, Komisioni zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit përpilon listë zyrtare të kandidatëve për zgjedhje të Kryetarit të Parlamentit Studentor,zgjedhje të kryetarit të Parlamentit të fakultetit dhe zgjedhje të anëtarëve të Parlamentit Studentor të fakultetit.

Në listën zyrtare Kandidatët radhiten sipas rendit alfabetik.

Propozimet dhe lista zyrtare e kandidatëve nga paragrafët e mësipërm, do të shpallen ne WEB faqen e Universitetit.

### **Neni 38**

Për kryetar të zgjedhur të Parlamentit Studentor të Universitetit konsiderohet kandidati i cili fiton shumicën e votave të studentëve të regjistruar në Universitet, të cilët morën pjesë në zgjedhje dhe kanë votuar.

### **Neni 39**

Më së voni 24 orë pas mbylljes së kutive të votimit, Komisioni zgjedhor i Parlamentit Studentor të Universitetit është i obliguar t'i shpallë publikisht rezultatet e votimit.

### **Neni 40**

Më së voni 5 ditë pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, Kryetari aktual i Parlamentit Studentor të Universitetit është i obliguar të caktojë mbledhje konstitutive në të cilën bëhet dorëzim-pranimi i detyrës së kryetarit të ri dhe anëtarëve të Parlamentit Studentor.

### **Neni 41**

Nëse Kryetari aktual nuk e cakton mbledhjen konstitutive në afat prej 5 ditësh nga dita e shpalljes së rezultateve, këtë mund ta bëjnë  $\frac{1}{2}$  e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të sapozgjedhur të Parlamentit Studentor të Universitetit.

### **Neni 42**

Kryetari i zgjedhur është i obliguar që në afat prej 3 ditësh pas fillimit të detyrës ta propozojë Kryesinë, programin e punës dhe dinamikën e aktiviteteve për periudhën e ardhshme.

### **Neni 43**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj.

**K R Y E T A R I**  
**i Parlamentit Studentor të Universitetit të Tetovës**